



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE**  
**KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE**  
**NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL**  
**“SHËRBIME KARROCERIE”**

**(Niveli III i KSHK<sup>1</sup>, referuar Niveli III në KEK<sup>2</sup>)**

**Kodi: M4-III-23**

**Tiranë, 2024**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

**Programi Orientues** për provimet përfundimtare të Kualifikimit Profesional “**Shërbime karrocierie**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë Kualifikim, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në të dy klasat e këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e arsimit të të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmblendhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t'i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

## **A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e teorisë profesionale të integruar, në Kualifikimin Profesional “**Shërbime karrocierie**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur, në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, që përmban Skeletkurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të orëve të lëndëve profesionale, të zhvilluara në klasën e 12-të.

**a) Lëndët profesionale** të përzgjedhura për t'u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura në të, janë si më poshtë.

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

<b>Nr</b>	<b>Lënda</b>	<b>Vëllimi i orëve për çdo lëndë</b>	<b>Peshat në %</b>
1	Shërbimet e karrocierisë në mjetet e transportit	87	100
	<b>TOTALI</b>	<b>87</b>	<b>100</b>

**b) Temat sipas lëndëve janë:**

Temat nga lënda “Shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit”, kl.12-të:

**Gjithsej 87 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për strukturën e automjetit, llojet e karrocërisë dhe shasive si dhe karakteristikat e tyre.	2 orë
Tema 2	Elementët e palëvizshëm strukturor të automjetit	2 orë
Tema 3	Elementët e lëvizshëm të jashtëm dhe të brendshëm jo strukturor të automjetit	4 orë
Tema 4	Llojet dhe mënyrat e lidhjeve dhe bashkimeve të elementëve dhe nyjeve të karrocërisë	2 orë
Tema 10	Klasifikimi dhe veçoritë e shërbimeve të karrocërisë në mjetet e transportit	4 orë
Tema 11	Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit	4 orë
Tema 15	Llojet e deformimeve të elementëve metalike të lëvizshëm dhe shkaqet e tyre.	3 orë
Tema 17	Llojet e deformimeve të elementëve plastike dhe kompozite të lëvizshëm, dhe shkaqet e tyre.	4 orë
Tema 19	Llojet e dëmtimeve të elementëve të palëvizshëm të karrocërisë dhe shasisë, si dhe shkaqet e tyre.	4 orë
Tema 21	Llojet e saldimeve, veçoritë dhe përdorimi i tyre në punimet e karrocërisë së mjeteve të transportit	6 orë
Tema 22	Pajisjet e saldimit që përdoren në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit. Karakteristikat, funksioni i tyre.	4 orë
Tema 23	Materialet mbushëse në saldime. Gazrat dhe deoksiduesit.	3 orë
Tema 28	Llojet e prerjeve, bashkimeve dhe lidhjeve në punimet e karrocërisë së mjeteve të transportit. Veçoritë dhe përdorimi i tyre	4 orë
Tema 30	Fenomeni i korrozionit në materialet metalike. Teknikat e riparimit për mbrojtjen nga korrozioni. Trajtimi i tij në shërbimet e karrocërisë	4 orë
Tema 33	Xhamat e automjeteve, mënyrat e zëvendësimit të tyre.	4 orë
Tema 34	Njohuri të përgjithshme për lyerjen dhe luçidimin e sipërfaqeve të ndryshme të karrocërisë.	6 orë
Tema 35	Procesi teknologjik i stukimit, lyerjes, pjekjes dhe luçidimit të sipërfaqeve të karrocërisë.	6 orë
Tema 36	Aksesorët e karrocërisë dhe të kabinës (bravat, dorezat, fshirëset e xhamave, mbajtëset e pasqyrave etj.), ndërtimi dhe parregullsitë e tyre.	6 orë
Tema 38	Njohuri për elementët e çmontueshëm të kabinës (dyer, parafango, parakolp, prapakolp etj.), punimet që kryhen në to.	5 orë
Tema 39	Njohuri për elementët e pjesës së brendshme të kabinës (AIRBAG, kroskot, ndenjëse, rripa sigurimi etj.) dhe punimet që kryhen në to.	5 orë
Tema 41	Teknologji për eliminimin e deformimeve të karrocërisë veglat, instrumentet dhe pajisjet e punës.	5 orë

**Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:**

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) orë dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i drejtimit/profilin të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

**Niveli I:** Rikujtimi / Të kuptuarit  
**Niveli II:** Zbatimi / Analiza  
**Niveli III:** Sinteza/ Vlerësimi

Shkolla përcakton numrin maksimal të pikëve të testit dhe harton skemën përkatëse të vlerësimit. Në tabelën në vijim, rekomandohet që numri maksimal i pikëve të jetë 40 dhe shpërndarja e pikëve të bëhet në raport me peshën e çdo lënde dhe nivelet e vështirësisë.

**Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve**

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit	100	60	24	24	12
<b>TOTALI</b>		<b>100%</b>	<b>60 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>24 pikë</b>	<b>12 pikë</b>

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësive të testit. Kështu, njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë, por mund të marrin edhe 2 (dy) pikë nëse përmbajnë jo thjesht rikujtim por edhe analizë dhe llogaritje; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda për brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuara dhe llojet e tjera të njësive të përfshira në test, marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrohen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara rekomandohet të jetë si më poshtë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 14	4
15 - 21	5

<b>22 - 29</b>	<b>6</b>
<b>30 – 36</b>	<b>7</b>
<b>37 - 43</b>	<b>8</b>
<b>44 - 52</b>	<b>9</b>
<b>53 - 60</b>	<b>10</b>

## **B. Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në Kualifikimit Profesional "Shërbime karrocieri", Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**a) Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

<b>Nr.</b>	<b>Kompetencat profesionale</b>	<b>Detyrat e punës</b>	<b>Pikët</b>
<b>1</b>	Të realizojë-punime të kontrollit dhe riparimit/zëvendësimit në pjesët e çmontueshme dhe të paçmontueshme jostrukturore të karrocierisë	<b>Detyra 1:</b> Punime në pjesët e çmontueshme dhe të pa çmontueshme jo strukturore të karrocierisë	25
<b>2</b>	Të realizojë punime të saldimit me hark elektrik, me gaz dhe me TIG, MIG, MAG në karrocieri	<b>Detyra 2:</b> Punime të saldimit me hark elektrik, me gaz dhe me TIG, MIG, MAG në karrocieri	25
<b>3</b>	Të realizojë punime të ngjitjes në karrocieri	<b>Detyra 3:</b> Punime të ngjitjes në karrocieri	15
<b>4</b>	Të realizojë punime të lyerjes së pjesëve metalike të karrocierisë	<b>Detyra 4:</b> Punime të lyerjes së pjesëve metalike të karrocierisë	20
<b>5</b>	Të realizojë punime të riparimit të aksesorëve në karrocieritë e mjeteve të transportit	<b>Detyra 5:</b> Punime të riparimit të aksesorëve në karrocieritë e mjeteve të transportit	15
<b>Shuma</b>			<b>100</b>

**b) Skema e vlerësimit me nota:**

<b>Pikët e fituara</b>	<b>Notat</b>
<b>0 - 40</b>	<b>4</b>
<b>41 - 50</b>	<b>5</b>
<b>51 - 60</b>	<b>6</b>
<b>61 - 70</b>	<b>7</b>
<b>71 - 80</b>	<b>8</b>
<b>81 - 90</b>	<b>9</b>
<b>91 - 100</b>	<b>10</b>

### **Shënime:**

Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “detyra pune”, në bazat e praktikave pranë shkollave profesionale për të gjitha ato procese, që garantoohen në mjediset e saj. Për procese që nuk garantoohen në bazën e praktikave të shkollës, ato mund të realizohen në mjedise reale pune (servise), që garantojnë kushtet për realizimin e tyre.

Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se **3 orë**, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.

Është e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme që për çdo detyrë, në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesi (organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje Respektimit të Rregullave të Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjes së Mjedisit gjatë gjithë kryerjes së detyrave për çdo nxënës.

Gjithashtu, duhet t’i lihet hapësirë bashkëbisedimit profesional, ku komisioni drejton pyetje të parapërgatitura për proceset kyçe, por dhe në çdo rast kur e shikon të arsyeshme që duhet të ndërhyjë me pyetje, sepse bashkëbisedimi profesional është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara më sipër.

Për çdo detyrë komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet e vlerësimit të detajuara, p.sh listë kontrolli, duke pasur parasysh programin e zhvilluar në këtë nivel, për të gjitha modulet e detyruara të praktikës profesionale, sipas kompetencave përkatëse të përfshira në skeletkurrikul.

Instrumentet e vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijnë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimin e vendit dhe mjeteve të punës, etj. Gjithashtu, është e rëndësishme të vlerësohet realizimi i standardeve dhe respektimi i procesit në kohë.

Për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.

Për çdo detyrë komisioni i provimit përfshin në vlerësim edhe disa kompetenca të përgjithshme, të cilat janë të rëndësishme, si vetëkontrolli, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi etj.

Është e rëndësishme, që nxënësit të pajisen me një material udhëzues, ku të përcaktohen detyrat që do të kryejnë, mënyra e vlerësimit të tyre, koha që duhet të kenë në dispozicion. Gjithashtu, mund t’u jepen tabela ndihmëse, ku paraqiten vlera për matje të caktuar sipas detyrave përkatëse, etj.

Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërin prej tyre. Komisioni i provimit duhet përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.

Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit. Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit

të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Udhëzime për Detyrën 1: “Punime në pjesët e çmontueshme dhe të pa çmontueshme jo strukturore të karrocërisë”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për “Shërbime karrocërie” të automjeteve ose në servise private për “Shërbime karrocërie” të automjeteve .

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të kontrollit dhe riparimit në pjesët e çmontueshme dhe të paçmontueshme jostrukturore të karrocërisë . Atyre i jepet detyrë të kryejnë punime në pjesë të çmontueshme jostrukturore të karrocërisë dhe në pjesë të paçmontueshme jostrukturore të karrocërisë.

Nxënësit i vihet në dispozicion koha e përshtatshme për realizimin e detyrës si dhe mjetet e pajisjet e nevojshme, si, katalogë, manuale, kompleti i veglave, instrumentet, automjeti mësimor, etj. Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre dhe pasi lexon udhëzimet përkatëse, realizon proceset e punës të çmontimit dhe montimit të pjesëve të karrocërive njëcopëshe ose të përbëra të automjeteve. Nxënësi vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e kryerje të detyrës. Ai vlerësohet me anë të listës së kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues.

**Udhëzime për Detyrën 2: “Punime të saldimit me hark elektrik, me gaz dhe me TIG, MIG, MAG në karrocëri”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për “Shërbime karrocërie” të automjeteve ose në servise private për “Shërbime karrocërie” të automjeteve .

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të parapërgatitjes dhe të realizimit të saldimit me hark elektrik, me gaz dhe me TIG, MIG, MAG të pjesëve të ndryshme në karrocëri.

Nxënësit i vihen në dispozicion aparate saldimit me hark elektrik, me gaz dhe TIG, MIG, MAG , materialet e nevojshme për saldimit të pjesëve të karrocërive, kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe saldime, karrocëri dhe pjesë të ndryshme të mjeteve të transportit, katalogë, manuale, etj.

Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, bën parapërgatitjen dhe kryen procesin e saldimit, duke përdorur teknikat e duhura të saldimit me hark elektrik, me gaz dhe TIG, MIG, MAG të elementit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet me anë të listës së kontrollit.

**Udhëzime për Detyrën 3: “Punime të ngjitjes në karrocëri”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për “Shërbime karrocërie” të automjeteve ose në servise private për “Shërbime karrocërie” të automjeteve .

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të riparimit me ngjitje të pjesëve të dëmtuara të karrocërive të mjeteve të transportit.

Nxënësit i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e domosdoshme, si, kompleti i veglave, instrumentet matës, automjeti mësimor, pjesë të karrocërive të automjeteve (parakolpë, maskarino, parafango, dyer, mbulesa motori dhe bagazhi), materialet e nevojshme për ngjitje të forta dhe të buta, katalogë, manuale, etj. Nxënësi pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e ngjitjes dhe të riparimit të pjesëve të karrocërive të përcaktuara nga komisioni duke përdorur teknikat dhe procedurat e duhura . Ai vëzhgohet nga komisioni në çdo hap pune që kryen. Ai do

të vlerësohet për realizimin e proceseve të punës, për kontrollin, matjen dhe riparimin si dhe për teknikat dhe procedurat e përdorura; me anë të listës së kontrollit.

**Udhëzime për Detyrën 4 : “Punime të lyerjes së pjesëve metalike të karrocërisë”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për “Shërbime karrocërie” të automjeteve ose në servise private për “Shërbime karrocërie ” të automjeteve .

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të stukimit, lyerjes dhe luçidimit të pjesëve metalike të karrocërisë.

Nxënësit i vihet në dispozicion mjetet, pajisjet, instrumentet, pjesë të ndryshme metalike të karrocërisë që mundësojnë realizimin e procesit teknologjik të lyerjes të pjesëve të karrocërisë, materialet e nevojshme për të realizuar procesin e lyerjes (stuko, bojëra etj.), katalogë, manuale, etj. Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, fillon punën duke përdorur teknikat dhe procedurat e duhura për realizimin e punimeve paraprake dhe kryesore të procesit të lyerjes së pjesëve metalike të karrocërisë sipas detyrës së dhënë. Nxënësi vëzhgohet nga komisioni në çdo hap pune dhe vlerësohet me anë të listës së kontrollit.

**Udhëzime për Detyrën 5: “Punime të riparimit të aksesorëve në karrocëritë e mjeteve të transportit ”.**

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për “Shërbime karrocërie” të automjeteve ose në servise private për “Shërbime karrocërie ” të automjeteve .

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të kontrollit dhe riparimit të aksesorëve të karrocërive të mjeteve të transportit.

Nxënësit i përcaktohen nga komisioni, punimet përkatëse dhe i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e domosdoshme, si, kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matjen, kontrollin dhe riparimin e aksesorëve të karrocërive të mjeteve të transportit, pjesë këmbimi dhe mekanizma të ndryshëm të aksesorëve të karrocërive, katalogë, manualë, etj. Ai punon në mënyrë individuale dhe do të vlerësohet me anë të listës së kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues.